

RELACION TEKNIK

Objekti: “Largimi i inerteve të rrugës provizore dhe kthimi i bregut të liqenit në gjendjen e mëparshme”

Me fonde të buxhetit për vitin 2020 është planifikuar “Largimi i inerteve të rrugës provizore dhe kthimi i bregut të liqenit në gjendjen e mëparshme”.

Gjatë zbatimit të objektit: “Sistemim asfaltim e masa inxhinierike në km.21+050 në rrugën Lin – Pogradec” ishte planifikuar dhe ndërtimi i një segmenti rrugor provizor.

Ky segment provizor me gjatësi rreth 800 m u ndërtua pothuajse në liqenin e Pogradecit duke zënë një pjesë të plazhit. Segmenti provizor u ndërtua si rezultat i shtimit të aksit të rrugës Lin – Pogradec në km.21+050 për shkak të memorandumit ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Ministrisë për Zhvillimin Urban dhe Turizmit, Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në nëntor 2014 për mbrojtjen dhe mos prishjen e dy bunkerëve pasi kanë vlera historike dhe kulturore.

Theksojmë se në preventivin e zbatimit të këtij segmenti provizor nuk ishte planifikuar prishja dhe kthimi në gjendjen e mëparshme të tij. Është marrë në konsideratë dhe kërkesa e Bashkisë Pogradec për depozitimin e materialeve në largësinë 15 km (vend depozitimin e miratuar).

Për depozitimin është parashikuar përhapja dhe ngjeshja.

Për këtë, grupi i punës i ngritur me Urdhërin të Drejtorit të Përgjithshëm nr.10, datë 29.01.2020 mbas inspektimit në vend hartoi preventivin e punimeve.

Në këtë preventive parashikohen:

- Punime gërmimi,
- Punime transporti dhe depozitimi,
- Punime për mbrojtjen e bunkerave,
- Punime për sistemimin e bregut të liqenit.



